

FJALA E DEPUTETIT ENKELEJD ALIBEAJ

E MËRKURË 9 NËNTOR 2022

I dashur Taulant,

Po, është e vërtetë që një projektligj me procedurë të përshpejtuar mund ta kërkojë Kryeministri, 1/5 e deputetëve (meqë ra fjala duhen 28 deputetë), por, në fakt, ka një arsye më të madhe, të cilën ti nuk pate guximin ta thoshe, se përse sot, teksa duhet të diskutojmë një nga gjërat më të rëndësishme të këtij parlamenti, që është buxheti, papritur dhe pakujtuar sillni, me procedurë të përshpejtuar, ligjin për portin e Durrësit. Që ta kuptojnë shqiptarët se çfarë do të thotë ligj me procedurë të përshpejtuar, është ta fusësh sot në kalendarin e punimeve dhe pas një jave (dy javë the ti) ta miratosh. Po ta them unë se cila është arsyeja kushtetuese, ligjore, morale, politike, financiare se përse të shtyn ty dhe ju të gjithëve, në fakt, me shtysën e këtij që është mbrapa, për të ecur shpejt, që edhe shqiptarët ta marrin vesh.

Ja, ky është projektligji që doni ta kaloni ju me shpejtësi të madhe. Është një projektligj, i cili ka një, dy, tre, katër nene, pesë bashkë me hyrjen në fuqi. Ka një arsye shumë të madhe. Ky është ligji që i kushton më shumë në 30 vjet këtij parlamenti që ka miratuar ligje. A e dini sa kushton apo jo? 2 miliardë e 100 milionë euro. A t'jua përsëris edhe një herë? 2 miliardë e 100 milionë euro është kostoja e këtij projektligji me 5 nene, 400 milionë euro një nen, dhe ju doni ta kaloni me procedurë të përshpejtuar sot, ditën që diskutohet buxheti, në këtë mjegullnajën e madhe, ta kaloni fshehtazi. Kjo është arsyeja më e madhe pse ju sot nuk po bëni gjë tjetër veçse jeni duke prerë shiritin e një afere ekonomike, e cila shumë shpejt mund të kthehet në një aferë korruptive. Po e them "mund" për të qenë i kujdesshëm edhe në të shprehur për një arsye shumë të thjeshtë, ka vetëm pesë nene. Ndërkohë, sapo e the, ka një vit që negociohet. Midis kujt negociohet? Çfarë është dhënë dhe çfarë është marrë? Sa është shumë që shteti fiton? Sa është territori i Shqipërisë që po shisni? Praktikisht unë arrij të kuptoj një gjë fare të thjeshtë, jeni duke shitur jo pak, por rreth 1 milionë metra katrorë nga zemra e Shqipërisë, porti i Durrësit, për 2 miliardë e 100 milionë euro.

Unë e kuptoj që kjo është një shumë e madhe, e cila do t'u mbyllë gojën shumë prej deputetëve kënde, do t'i mbyllë gojën edhe medies, shumë prej medie, do t'u mbyllë gojën shumë prej analistëve; mund t'u mbyllë gojën edhe organizatave të shoqërisë civile, por gojën e deputetëve të opozitës, që janë të pakapur, nuk do ta mbyllë kurrë. Ky është detyrimi që kemi ne.

Bëni një gjë fare të thjeshtë, minimale, vendoseni parlamentin e Shqipërisë, deputetët e Shqipërisë, në kushtet për të parë se çfarë pazari keni bërë, me kë e keni bërë, sa fiton shteti shqiptar. Nëse keni zgjedhur njërin që do të vijë këtu, i paska lindur në shpirt dhe në zemër që të investojë 2 miliardë e 100 milionë euro, (me thënë të drejtën, unë jam i hapur që ky vend i varfër të ketë sa më shumë investime të huaja) të paktën ta dimë nëse ka pasur ndonjë subjekt tjetër që të jetë i interesuar. Minimalisht, a ka pasur një procedurë të thjeshtë konkurruese që zemrën e Shqipërisë, zemrën e Durrësit, portin e Durrësit, të mund t'ia ofronte dikujt, që mund të ofronte më tepër para se kaq? Ku është transparenca në këtë mes? Nëse ka pasur një element vërtet problematik ky parlament, kanë qenë pikërisht ligjet me porosi.

Po ju them shqiptarëve: harrojeni ligjin e teatrit, harrojeni ligjin e aeroportit të Vlorës, harrojeni "Air Albania"; harrojeni "Lotarinë Kombëtare", nuk janë asgjë para kësaj afere, po e quaj ekonomike deri tani, prej 2 miliardë e 100 milionë eurosh, të cilën ju doni ta kaloni me shpejtësi, vjedhurazi. Është e drejta e këtij parlamenti që, nëse qeveria deri tani e ka mbyllur gjithçka në kasafortë, askush nuk e di si i ka zhvilluar negociatat, ku ka ngrënë dhe ku ka pirë, deri tani e dimë se ka ngrënë te Nusreti, kaq e dimë, këtë po, të dije më shumë.

Këtu po i kthehem fjalës që the pak më parë, se kjo duhet të bëjë bashkë edhe njërin palë, edhe palën tjetër, jo, jo kjo nuk na bën bashkë, sepse kjo nuk është prona jonë, kjo është prona e shqiptarëve, ndaj minimalisht kemi detyrimin t'u tregojmë shqiptarëve se çfarë po ndodh me pronën e tyre. Ku i lind e drejta qeverisë apo parlamentit që të shesë diçka që nuk ka të drejtë ta bëjë? Askush nuk e di. Ju vini sot, vjedhurazi, për aferën më të madhe ekonomike.

Në këtë situatë ku jam kërkoj vetëm një gjë, që ky parlament të mos e miratojë sot me shpejtësi këtë ligj. Ky është një ligj kaq i rëndësishëm, 2 miliardë e 100 milionë euro, nuk ka parë ky vend, që duhet të vazhdojë me procedurën e tij normale, ku qeveria të sjellë të gjitha dokumentet për të cilat bën fjalë ky ligj në këto pesë nene, por askush nuk i di. Janë minimalisht tetë shtojca, aq kam numëruar deri tani, ku tregohet realisht se çfarë pazari është bërë me portin e Durrësit, t'i lexojmë, që të kuptojmë, sepse bën vaki se edhe mund të biem dakord, por, për faktin që nuk i keni sjellë sot dhe doni ta kaloni me shpejtësi, kam frikë se aty fshihet djalli, te detajet, te këto marrëveshje, që ta kuptojnë shqiptarët, dhe, në fund të fundit, t'ua bëni me dije të gjithë atyre që nuk u mbyllet goja, siç jemi ne pjesa këndeje.

Unë sot kam një thirrje për atë që shumë shpejt duhet të përballet me këtë gjë, Presidentin e Republikës, të cilit duhet t'ia çoni pas dy javësh: ne sot kemi detyrim t'ju bëjmë me dije që do të

përballeni me një procedurë parlamentare të korruptuar. Sot po u bëj thirrje organeve të drejtësisë, sot është prerja e shiritit të një afere ekonomike, e cila shumë shpejt, me daljen në dritë të dokumenteve, që ju i mbani të fshehur sot, mund të shndërrohet në aferën më të madhe korruptive, puna e përditshme e organeve të reja të drejtësisë. Shmangeni këtë, nëse jeni të sinqertë, bëjani këtë detyrim deputetëve, bëjani prezent gjithçka publikut. A është një gjë për shqiptarët, a është në të mirë të shqiptarëve, a do të sjellë më shumë para për shqiptarët, a do të sjellë më shumë mirëqenie ekonomike për shqiptarët? Jepjani këtë kënaqësi vetes duke bërë transparente gjithçka. Bëjeni këtë. Kjo është mënyra më e mirë për të hequr çfarëdolloj hije dyshimi mbi atë se çfarë është duke u gatuar në këtë parlament. Jam i sigurt që shumica juaj nuk dinë asgjë, thjesht dhe vetëm jeni noterë të një veprimtarie okulte, me shumë gjasa korruptive, të qeverisë.

Dinjitetin e parlamentarit vendoseni në vend. Keni vendosur dorën mbi Kushtetutë se do t'i bindeni Kushtetutës, se do të mbronin interesat e drejta të qytetarëve shqiptarë që ju kanë votuar. Sot është momenti, tani është momenti: hiqni dorë nga miratimi me procedurë të përshpejtuar, bëjeni transparente gjithçka, jepni kohën e duhur që gjithkush të shohë dhe të ketë të drejtën të japë opinionin e tij. Kjo është mënyra më e mirë për t'i shërbyer Shqipërisë dhe shqiptarëve, përndryshe është një interes i vogël juaji. Shumë faleminderit!